



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE E GJILANIT**  
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

**AD.GJTH.GJL.nr.17/24**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, duke vepruar sipas ankesës së parashtruar nga ankuesi K. A. nga fshati Skifteraj, komuna e Vitisë, të datës 27.09.2024, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit R. F. - gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Viti, më datë 14.10.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZHET e pabazuar** ankesa e parashtruar nga K. A. nga fshati Skifteraj, komuna e Vitisë, e datës 27.09.2024, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit R. F. - gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Viti, konform Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

**A r s y e t i m**

Me datë 27.09.2024, ankuesi K. A. nga fshati Skifteraj, komuna e Vitisë, i është drejtuar kryetarit të gjykatës me ankesë<sup>1</sup> ndaj gjyqtarit R. F. - gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Viti, duke theksuar se sa i përket lëndës në fjalë, për shkaqe të paqarta për të, kjo lëndë nuk merret në procedim, përkatësisht e njëjta është kthyer në rigjykim qysh në fillim të këtij viti dhe akoma nuk është caktuar për shqyrtim.

Kryetari i gjykatës i ka kërkuar gjyqtarit të çështjes të deklarohet lidhur me pretendimet e ankuesit.

Gjyqtari R. F. në deklaratën e tij lidhur me pretendimet e ankuesit ka theksuar se kjo çështje kontestuese është iniciuar për herë të parë më datë 07.08.2018, ndërsa ka përfunduar meritorisht më datë 14.10.2019, për të cilën është përpiluar Aktgjykimi C.nr.44/2019. Aktgjykimi në fjalë është prishur nga gjykata e shkallës së dytë sipas aktvendimit të datës 27.12.2023, ndërsa është pranuar në shkrimoren e gjykatës më datë 15.01.2024, e në zyrën e gjyqtarit më datë 04.03.2024 dhe ka marrë numrin e rigjykimit C.nr.895/2024. Me të pranuar lëndën, është caktuar shqyrtimi gjyqësor për datë 26.04.2024, e cila seancë është shtyrë për shkak të kërkesave të dy përfaqësuesve të palëve në kontest, pastaj janë caktuar seancat e

<sup>1</sup> Të njëjtin, kryetari i gjykatës e ka pritur edhe në takim.

tjera për datë 04.06.2024 dhe 03.07.2024, të cilat nuk janë mbajtur në mungesë të plotësimi të kushteve ligjore. Seanca e radhës është caktuar për datë 18.10.2024 dhe palët janë thirrur rregullisht për këto seanca. Pretendimeve të tij, gjyqtari i çështjes i ka bashkëngjitur provat: pranimin e lëndës nga Gjykata e Apelit të Kosovës në shkrimoren e gjykatës ku konstatohet se e njëjta është pranuar më datë 15.01.2024; dorëzimin e lëndës në zyrën e gjyqtarit R. F. ku konstatohet se e njëjta është dorëzuar më datë 04.03.2024; kërkesat për shtyrje të seancës së caktuar për datë 24.06.2024 nga përfaqësuesit e palëve; si dhe fletëkthesat për pranimin e thirrjeve për seancat e caktuara për datë 04.06.2024, 03.07.2024 dhe 18.10.2024.

Kryetari i gjykatës, pas pranimit të ankesës të paraqitur nga pala ankuese (paditësi sipas lëndës C.nr.895/2024), deklaratës së paraqitur nga gjyqtari R. F. dhe analizimit të pretendimeve të ankuesit, ka gjetur se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë më ndonjë shkelje të mundshme disiplinore, prandaj ankesa e të njëjtit është e pabazuar dhe pretendimet në të nuk e justifikojnë inicimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit në fjalë.

Deri te një përfundim i tillë, kryetari i gjykatës erdhi pasi konstatoi se lënda e kthyer në rigjykim, është caktuar për shqyrtim gjyqësor menjëherë në muajin vijues që nga koha kur e ka pranuar të njëjtën, pra gjyqtari R. F. e ka pranuar lëndën e rigjykimit më datë 04.03.2024, ndërsa seancën e ka caktuar për muajin tjetër më datë 26.04.2024. Kryetari i gjykatës konstatoi se nuk qëndrojnë as pretendimet tjera të ankuesit se nuk është proceduar me lëndën, pasi nga fletëkthesat që i ka bashkëngjitur si prova gjyqtari në deklaratën e tij, shihet se përfaqësuesit e palëve në procedurë kanë pranuar thirrjet për shqyrtim gjyqësor për datat 26.04.2024, 04.06.2024, 03.07.2024 dhe 18.10.2024. Madje, vet përfaqësuesit e palëve kanë kërkuar shtyrjen e seancës së datës 26.04.2024. Nga këto gjetje, kryetari i gjykatës vlerëson se nuk mund të konsiderohet se gjyqtari në fjalë ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë dhe Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë, meqë i njëjti ka caktuar shqyrtimin gjyqësor brenda afatit ligjor pas pranimit të lëndës së rigjykimit në zyrën e tij.

Kryetari i gjykatës, bazuar në nenin 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, ka gjetur se ankesa e K. A. e datës 27.09.2024, është e pabazuar dhe për të njëjtën ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Kryetari i Gjykatës,  
Venhar Salihu**

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet i dorëzohet:

1. Gjyqtarit R. F.,
2. Parashtruesit të ankesës,
3. KGJK-së
4. Dosjës së lëndës.